



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS
ADMINISTRATORI

Nr. 446/ Prot.

Durrës, më 03/02/2025.

FTESË PËR OFERTË

"IDENTITETI I MARKËS (BRENDIMI) PËR PROJEKTIN "MBROJTJA E MJEDISIT NËPËRMJET MENAXHIMIT TË INTEGRUAR TË MBETJEVE NË BASHKINË DURRËS, FINANCUAR NGA IADSA".

me fond limit total = 497 700 (katërqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e shtatëqind) lekë Pa TVSH.

Drejtuar: TË GJITHË OPERATORËVE EKONOMIK TË INTERESUAR PËR TË MARRË PJESE

Publikuar në website-n e Universitetit Aleksandër Moisiu, Durrës - www.uamd.edu.al

Ju fton të paraqisni ofertën tuaj me objekt **"IDENTITETI I MARKËS (BRENDIMI) PËR PROJEKTIN "MBROJTJA E MJEDISIT NËPËRMJET MENAXHIMIT TË INTEGRUAR TË MBETJEVE NË BASHKINË DURRËS, FINANCUAR NGA IADSA" sipas kërkesave të specifikuara si më poshtë (bashkëlidhur) :**

Në mbështetje të ligjit Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë, në kuadër të zbatimit të projektit "Mbrotjtja e mjedisit nëpërmjet menaxhimit të integruar të mbetjeve në Bashkinë Durrës", projekt me koordinator Bashkinë Durrës dhe partnerë Instituti i Kërkimeve Urbane (Urban Research Institute) dhe Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës, me Ref.No. IADSA II/2023/2015, pikës 5.2 të IADSA Project and Financing Contract, rregullave të PRAG- Practical Guide 2025, konsiderohet e nevojshme realizimi i kësaj procedure sipas përcaktimeve si më poshtë vijon:

Të dhënat e projektit:

Titulli i Projektit:	Mbrojtja e mjedisit nëpërmjet menaxhimit të integruar të mbetjeve në Bashkinë Durrës
Kohëzgjatja (në muaj)	24 muaj
Data e fillimit të projektit	18/12/2023
Institucioni koordinator	Bashkia Durrës
Partnerët	Instituti i Kërkimeve Urbane, Universiteti

Adresa: Lagja Nr.1, Rr "Taulantia", Durrës, Tel: +355 52 39161, www.uamd.edu.al

Aleksandër Moisiu, Durrës

Objektivi i përgjithshëm i projektit “Mbrojtja e mjedisit nëpërmjet menaxhimit të integruar të mbetjeve në Bashkinë e Durrësit”, është të kontribuojë në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe mbrojtjen e mjedisit nëpërmjet promovimit të menaxhimit të integruar të mbetjeve, praktikave të mira të konsoliduara të reduktimit të mbetjeve dhe optimizimit të kostos, edukimit të brezave të rinj dhe përdorimin e teknologjive të reja, në përputhje me Programin e dytë të thirrjes për propozime IADSA.

Projekti është gjithashtu në përputhje me Planin Kombëtar të Veprimit për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit (SSA) dhe Programin e Bashkëpunimit për Zhvillimin Shqiptar të Italisë.

Projekti synon të aftësojë Bashkinë e Durrësit në arritjen e mbrojtjes së mjedisit dhe menaxhimit adekuat të mbetjeve bashkiake në territorin e saj, si dhe përmbushjen e detyrimeve kombëtare në përputhje me politikatat dhe kërkesat strategjike të vendit në fushën e menaxhimit të mbetjeve. .

Bazuar në sa më sipër, projekti i propozuar synon objektivat specifike të mëposhtme:

- 1) Të sigurojë menaxhimin e integruar të mbetjeve në Bashkinë e Durrësit nëpërmjet një planifikimi adekuat dhe gjithëpërfshirës;
- 2) Stimulimi i zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik dhe mbrojtjes së mjedisit nëpërmjet promovimit të reduktimit të mbetjeve, optimizimit të kostove dhe menaxhimit të mbetjeve në Bashkinë e Durrësit;
- 3) Fuqizimi i bashkëpunimit dhe partneritetit ndërmjet dhe ndërmjet qytetarëve, ndërmarrjeve dhe institucioneve për përgatitjen dhe zbatimin e projekteve dhe iniciativave të përbashkëta.
- 4) Ndërgjegjësimi, komunikimi dhe edukimi i qytetarëve, studentëve, institucioneve publike dhe publikut të gjerë për menaxhimin e mbetjeve dhe masat për reduktimin e mbetjeve.

Gjithashtu, projekti është në përputhje me udhëzimin e thirrjes së dytë për propozim të IADSA II dhe strategjive kombëtare pasi synon rritjen e njohurive dhe angazhimin e 5000 nxënësve, 300 mësuesve dhe 1000 qytetarëve në bashkinë e Durrësit duke ndërgjegjësuar dhe kapacitetet bashkëpunuese mes qytetarëve, institucioneve publike dhe ndërmarrjeve.

Fokusi kryesor i projektit do të jetë mbrojtja e mjedisit dhe zhvillimi ekonomik përmes promovimit të menaxhimit të integruar të mbetjeve me edukim, trajnim dhe veprime mbi përfitimet e riciklimit.

Këto objektiva kontribuojnë në procesin e zhvillimit të qëndrueshëm dhe janë në përputhje me ligjet dhe strategjitë e miratuara në nivel kombëtar dhe vendor në Shqipëri, dhe kanë mbështetjen e aktorëve kryesorë pasi janë thelbësorë për procesin shqiptar të integrimit në BEGjithashtu, ky projekt është gjithashtu në përputhje me Politikatat Strategjike dhe Planin Kombëtar të Veprimit për Menaxhimin e Mbetjeve (Strategjia), Planin Sektorial për Menaxhimin e Mbetjeve në Shqipëri (Masterplan) dhe Ligjin Nr. 10463 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” Aktivitetet e planifikuara të projektit do të kontribuojnë në përmbushjen e këtyre objektivave dhe në këtë mënyrë do të përmirësojnë kushtet socio-ekonomike në Bashkinë e Durrësit.

• **Nga sa më lart kërkohet:**

Shërbim identiteti i markës (brendimi) që do të prodhohet, detyrë e UAMD-së, në kuadër të veprimeve që lidhen me vizibilitetin dhe komunikimin e ndërgjegjësimit të publikut për zbatimin e projektit:

Konkretisht:



- a) Krijimi i logos dhe përdorimi i logos në produktet e printuara si banera, stirolapsa, canta etj.
- b) Shkarkimi i logos në një sërë formatesh dhe madhësish duke përfshirë formatet e njohura në media sociale;
- c) Ngjyrat shkronjat dhe simbolet duhet të jenë unike dhe të prezantojnë në mënyrë të qartë projektin.

- **Objektivi i ekspertizës:**

Zhvillimi i identitetit grafik të projektit është që ky identitet grafik të komunikojë në mënyrë efektive misionin dhe vlerat e projektit, duke siguruar përfaqësim të qëndrueshëm vizual në të gjitha materialet dhe platformat e projektit.

Aktivitetet kryesore do të përfshijnë por nuk do të kufizohen në:

Dizenjimin e materialeve vizuale tërheqëse dhe moderne për të përcjellë mesazhet kryesore të projektit, për audiencat e synuara në përputhje me kërkesat e partnerëve të tilla si: logo, fletëpalosje, infografikë, broshura dhe cdo dizajn tjetër që kërkohet për të përmbushur objektivat e komunikimit të projektit.

- **Fusha e punës:**

Operatori ekonomik fitues do të jetë përgjegjës për:

- Zhvillimi i identitetit grafik
- Krijimi i një identiteti unik të projektit duke përfshirë sugjerimet për akronimin dhe identitetin vizual;
- Dizajnimi i një logoje e cila pasqyron fokusin e projektit dhe lidhet me territorin
- Krijimi i paletës së ngjyrave dhe tipografisë së shkrimit të cilat janë në linjë me fokusin e projektit.
- Krijimi i modeleve/shembujve të dokumentave që do të gjenerohen përgjatë projektit;

- **Materiale e marketingut:**

- a) Specifikimet e projektimit dhe prodhimit për:
- b) Roll-up/baner për projektin i cili do të përdoret në evente publike;
- c) Broshura dhe fletëpalosje për shpërndarje publike
- d) Modele/Shembuj të prezantimeve në Power Point;
- e) Dosje për projektin
- f) Stirolapsa me logon e projektit
- g) Usb me logon e projektit;

Materiale të tjera të cilat shërbejnë për promovimin e projektit të cilat do të konsultohen/diskutohen paraprakisht me partnerët e projektit.

- **Paketa e Identitetit Grafik**

- Logo në formate të ndryshme(AI, EPS, PDF, PNG, JPG)
- Paleta e ngjyrave me kode ngjyrash(CMYK, RGB, PANTONE)
- Specifikimet e tipografisë



- Udhëzimet e përdorimit të identitetit grafik në produkte të ndryshme të listuara më lart;
- **Materiale të tjera specifike do të dakortësohen me partnerët e projektit pas përzgjedhjes së operatorit ekonomik fitues.**

Afati i realizimit të shërbimit:

- Afati i realizimit të shërbimit do të jetë 25 (njëzet e pesë) ditë nga momenti i nënshkrimit të Kontratës.
- Për procesin e implementimit të këtij shërbimi, Operatori Ekonomik Fitues duhet të përgjigjet për cdo kërkesë të Autoritetit Kontraktor në lidhje me këtë projekt deri në Maj 2025.

Gjatë kësaj kohe, Operatori Ekonomik duhet të parashikojë:

- Takim me partnerët e projektit në lidhje me kërkesat specifike të identitetit grafik;
- Punë për zhvillimin e identitetit grafik të projektit
- Prezantimi me 3 (tre) opsione të identitetit grafik i partnerëve të projektit.
- Reflektimi i komenteve të ardhura dhe ndryshimi i tyre, në mënyrë që të arrihet produkti final, i cili plotëson të gjithë kërkesat për prezantimin dhe komunikimin e projektit.

Pronësia Intelektuale:

Të gjithë materialet e prodhuara sipas kësaj kontrate, do të bëhen pronë ekskluzive e partnerëve të projektit (Bashkia Durrës, Universitetit Aleksandër Moisiu, Durrës dhe Instituti i Kërkimeve Urbane).

KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT

1. Kërkesat e përgjithshme për pranimin e kandidatëve

1. Të ketë aftësi të mira bashkëpunuese dhe të jetë fleksibël për të adresuar kërkesat e partnerëve;
2. Përvojë në zhvillimin e materialeve dygjuhëshe (shqip dhe anglisht).
3. Aftësi të shkëlqyera komunikimi dhe shkrimi;
4. Përgjegjësi, iniciativë dhe korrektësi e lartë;
5. Aftësia për të inkurajuar dhe lehtësuar bashkëpunimin ndërmjet subjekteve institucionale;
6. Aftësi të mira kompjuterike;
7. nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 76 të LPP,

2. Kërkesat e veçanta për pranimin e kandidatëve

1. Diplomë Bachelor në Dizajn / Pikturë – Grafik.

Diploma (nese kanë përfunduar jashtë vendit duhet të paraqitet edhe njësimi i diplomës nga Ministria e Arsimit dhe Sportit ose Certifikatë në Fushën e Dizajn referuar objektit të projektit, të lëshuar nga Institucione të licensuara në Republikën e Shqipërisë ose ekuivalent.

2. Aftësi në Adobe Creative Suite (Photoshop, Illustrator, InDesign);
3. CV/Portofol që demonstroi punën në projekte të ngjashme.

4. Formularin e Ofertës .
5. Deklaratë mbi përmbushjen e kriterëve të përgjithshme sipas Shtojcës këtu bashkëlidhur;
6. Deklaratën mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës këtu bashkëlidhur;

Operatori ekonomik duhet të dorëzojë në një zarf të mbyllur me shënimin “MOS E HAPNI, ME PËRJASHTIM TË RASTEVE KUR ËSHTË I PRANISHËM KOMISIONI I VLERËSIMIT TË OFERTËS, DHE JO PARA dd/mm/vv _____ orës _____“, duke specifikuar projektin, objektin e shërbimit për të cilin paraqet ofertën ekonomike, pranë autoritetit kontraktor me protokoll, jo më vonë se data dhe ora e caktuar, dokumentacionin si më poshtë (dhe sipas shtojcave bashkëlidhur)

- AFATI I FUNDIT PËR DORËZIMIN E DOKUMENTAVE DO TË JETË DATA 05.03.2025, ORA 11:00, NË ZYRËN E PROTOKOLL ARSHIVËS SË UNIVERSITETIT ALEKSANDËR MOISIU, DURRËS ME ADRESË LAGJA NR.1, RRUGA TAULANTIA, CURRILA DURRËS.
- MOSPARAQITJA BRENDA AFATIT TË PËRCAKTUAR PËRBËN KUSHT PËR SKUALIFIKIM.

Dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

4. KRITERI I VLERËSIMIT/EVALUATION CRITERIA:

- Çmimi më i ulët i ofertës së përgjegjshme dhe që përmbush kërkesat e specifikuara.

1. AFATET E EKZEKUTIMIT:

Afati i realizimit të shërbimit do të jetë 25 (njëzet e pesë) ditë nga momenti i nënshkrimit të Kontratës.

ADMINISTRATOR

Gerald ÇEKA



Datë ___/___/2025.

FORMULARI I OFERTËS

Emri i Ofertuesit _____

Për: Universitetin Aleksandër Moisiu, Durrës

* * *

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **“Identiteti i markës (brendimi) për projektin “Mbrojtja e mjedisit nëpërmjet menaxhimit të integruar të mbetjeve në Bashkinë Durrës, financuar nga IADSA”.**

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

1. Çmimi total i ofertës sonë është _____ (vlera ne fjale) leke pa TVSH;

Nënshkrimi i ofertuesit _____

Vula

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik]

DEKLARATË MBI PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME

Deklaratë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____ me cilësinë _____ të operatorit ekonomik deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Operatori ekonomik _____ nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 76 të LPP.
- Operatori ekonomik _____ nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.
- Operatori ekonomik _____ nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).
- Operatori ekonomik _____ ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatorit ekonomik si më sipër.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Nënshkrimi i ofertuesit _____
Vula _____



Shtojcë

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik]

DEKLARATA

Mbi Konfliktin e Interesit

Deklarata

Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se jemi të vetëdijshëm për sa vijon: Konflikti i interesit është një situatë e konfliktit midis detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari, në të cilën ai / ajo ka interesa private direkte ose indirekte që ndikojnë, ose që mund të ndikojë ose që duket se ndikojnë në kryerjen e padrejtë të detyrave dhe detyrimeve publike.

Në përputhje me nenin 21, paragrafi 1, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve siç parashikohen në Kapitullin III, Seksioni II, që janë absolutisht të ndaluara të përfitojnë drejtpërdrejt ose indirekt nga nënshkrimi i kontratave midis një pale dhe institucionit publik janë:

- Presidenti i Republikës, Kryeministri, Zëvendës Kryeministri, Ministrat, ose Zëvendësministrat, Deputetët, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kreu i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët dhe Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Gjykatës së Apelit, Avokati i Popullit, Anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, Anëtarët e Enteve Rregullatore (Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zëvendësguvernatorin; konkurrenca; telekomunikacioni; energjia elektrike; furnizimi me ujë; sigurimi; bonot; autoritetet e medias), sekretarët e përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar publik në çdo institucion publik pozicioni i të cilit është i barabartë me atë të Drejtorit i Përgjithshëm, drejtuesit e organeve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil.

Për nëpunësit civilë të nivelit të mesëm, sipas nenit 31 dhe zyrtarët sipas nenit 32 të kreut III, seksionit 2 të këtij ligji, ndalimi në paragrafin 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, siç përcaktohet këtu të zbatohet vetëm në rast të lidhjes së kontratave brenda fushës dhe territorit të institucionit dhe juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim do të zbatohet edhe kur pala në kontratë është një institucion varësie.

Kur zyrtari është kryetar bashkie ose nënkryetar i një bashkie ose komune, ose kryetar i një këshilli rajonal, anëtar i këshillit përkatës, ose një zyrtar i lartë i menaxhimit të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave private të zyrtarit, specifikuar këtu, do të zbatohet vetëm në rastin e lidhjes së kontratave, nëse ka, me bashkinë, komunën ose rajonin ku zyrtari ushtron një detyrë të tillë. Ky ndalim do të zbatohet gjithashtu kur pala në kontratë është një institucion publik në varësi të kësaj njësie (neni 21, paragrafi 2, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005).

Ndalimet e parashikuara në nenin 21, paragrafët 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, do të zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin, d.m.th. **bashkëshortin, bashkëjetuesin, fëmijët madhorë e prindërit e zyrtarit dhe të bashkëshortit dhe bashkëjetuesit.**



Unë i nënshkruari _____, me cilësinë e përfaqësuesit të personit juridik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time personale se:

Jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të parashikuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksioneve Publike", të ndryshuar, dhe aktet nënligjore të miratuara në bazë të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimi dhe Kontrolli i Pasurive, si dhe Ligjin Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik".

Në përputhje me to, unë deklaroj këtu se asnjë zyrtar publik, siç përcaktohet në Kapitullin III, Seksioni II të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk ka ndonjë interes privat, direkt ose indirekt, me personin juridik që unë përfaqësoj këtu.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

Vula _____